

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6371
E hënë, 26 korrik 2021
çmimi 0.40 €

Ujkani: Kosova vazhdon të përballet me ambient jofavorizues për investimet e huaja



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT DITË ZIE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PAS AKSIDENTIT ME AUTOBUS NË KROACI QË LA TË VDEKUR DHJETË PASAGJERË DHE MBI 40 TË LËNDUAR

SOT DITË ZIE NË KOSOVË



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka shpallur të hënën ditë zie shtetërore, pas aksidentit me autobus në Kroaci, ku mbetën të vdekur dhjetë pasagjerë (nëntë bashkatdhetarë dhe njëri nga shoferët e autobusit), kurse mbi 40 të lënduar, 15 prej këtyre në gjendje të rëndë shëndetësore. Autobusi me targa të Kosovës që bartte 67 pasagjerë ka dalë nga rruga në autostradën afër Sllavonski Brodit në Kroaci rreth orës 6:00 të mëngjesit të së dielës. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD) ka njoftuar se të vdekurit janë bashkatdhetarë të cilët kanë qenë duke udhëtuar në linjën e rregullt Frankfurt - Prishtinë

FEJTON

LIRIA KA EMRIN UÇK F. 10-11



Nait HASANI

AKTUALE

PËR TRI DITË 400 BASHKATDHEARË VIZITUAN KUVENDIN F. 7

DREJTORËT KOMUNALË TË ARSIMIT KËRKOJNË QË MËSIMDHËNËSIT TË VAKSINOHEN F. 6



EKONOMI

KAPEN NË DOGANË RRETH 75 MIJË CIGARE, U TENTUA TË SHMANGET TAKSA MBI 100 MIJË EURO F. 8

SPORT

DISTRIA KRASNIQI, E ARTË NË LOJËRAT OLIMPIKE TOKIO 2020 F. 14



KUR MUND TË JENË SHQETËSUESE SIMPTOMAT PAS VAKSINIT?

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Protesta në disa qytete evropiane kundër rregulloreve për Covid-19

PARIS, 25 KORRIK- Dhjetëra mijëra protestues kanë dalë nëpër rrugët e disa qyteteve evropiane më 24 korrik për t'i shprehur pakënaqësitë e tyre ndaj rregullave për vaksinim kundër koronavirusit. Protestat më të mëdha janë zhvilluar në Francë, ku besohet se 160 000 persona kanë protestuar në këtë shtet kundër një projektligji i cili kërkon që secili person të ketë leje speciale për të hyrë në restorante dhe institucione të tjera publike. Përmes këtij projektligji autoritetet franceze e kanë bërë të detyrueshëm vaksinimin e gjithë stafit shëndetësor.

Shumica e protestave kanë qenë të qeta, mirëpo në Paris, ku kanë protestuar rreth 11 000 persona, policia ka hedhur gaz lotsjellës ndaj protestuesve që kanë bërë turr "Liri". Një protestues është raportuar të ketë hedhur një karrige drejt një zyrtari policor. Policia më vonë ka përdorur edhe topa uji për t'i shpërndarë protestuesit.

Ministri i Punëve të Brendshme i Francës, Gerald Darmanin, ka thënë se nëntë persona janë arrestuar si dhe ka kritikuar protestuesit për dhunën ndaj policëve dhe gazetarëve.

Ligjvënësit në Senatin e Francës kanë diskutuar për projektligjin më 24 korrik, pasi dhoma e ulët e parlamentit e ka miratuar të njëjtin një ditë më parë.



Shumica e të rriturve francezë janë të vaksinuar plotësisht kundër koronavirusit dhe një mori sondazhesh tregojnë për mbështetje të madhe ndaj masave të reja.

Projektligji mëton ta zgjerojë përdorimin e "pasaportës shëndetësore", që tani kërkohet për hyrje në muze, teatro dhe zona turistike. Nëse ndryshimet miratohen, kjo pasaportë më pas mund të kërkohet edhe në bare e restorante dhe në disa hapësira të tjera.

Për të siguruar këtë pasaportë, banorët e Francës duhet të jenë të vaksinuar plotësisht, të kenë test

negativ për koronavirus, apo të kenë vërtetim se janë të shëruar nga virusi.

Debatit për këtë dokument është zhvilluar teksa autoritetet franceze janë duke regjistruar mbi 20 000 raste të infektimit me koronavirus në ditë.

Ndërkohë në Itali, mijëra persona janë mbledhur në Romë, Milano, Verona dhe qytete të tjera, më 24 korrik, në protesta paqësore, kundër vendimit të Qeverisë italiane për t'iu kërkuar banorëve të ashtuquajturën "pasaportë të gjelbër", për të hyrë në ambiente të mbyllura nëpër restorante, kinema dhe hapësira të tjera.

Në qytetin Verona mijëra

protestues kanë bërë turr "Jo pasaportë të gjelbër" dhe "Liri". Në mesin e protestuesve ka pasur familjarë me fëmijë të vegjël dhe staf shëndetësor, disa prej të cilave kanë thënë se janë duke rrezikuar që të humbin vendin e punës. Ka pasur persona që e kanë konsideruar pasaportën e gjelbër si vendim të marrë nga diktatorët fashistë.

Pavarësisht prej kundërshtimeve, vendimet e reja në Itali, që do të zbatohen nga 3 gushti, kanë rritur numrin e termineve për vaksinim. Deri më tani gjysma e të rriturve në Itali janë vaksinuar plotësisht.

Policia në Greqi, ndërkaq, ka përdorur gaz lotsjellës dhe topa uji

për t'i shpërndarë protestuesit e mbledhur në Athinë, për t'i kundërshtuar vaksinimet e detyrueshme.

Më shumë se 4 000 persona janë mbledhur jashtë parlamentit grek për të tretën herë këtë muaj, për t'i kundërshtuar vaksinimet e detyrueshme për disa punëtorë shëndetësorë. Një zyrtar policor ka thënë se disa protestues kanë hedhur bombola naftë, çka ka shtyrë policinë të përgjigjet me gaz lotsjellës, ka raportuar agjencia e lajmeve "Reuters".

Dhjetëra mijëra persona kanë protestuar edhe në Brazil, duke kërkuar shkarkimin e presidentit Jair Bolsonaro për shkak të mënyrës si e ka menaxhuar pandeminë.

Kjo ka qenë java e katërt e protestave të thirrura nga partitë e majta, sindikatat e punës dhe grupet kundër Bolsonaros.

Në Rio de Zhaneiro dhe vende të tjera protestuesit janë ankuar për vonesa në programin e vaksinimit në Brazil ashtu sikurse edhe për shkallën e lartë të papunësisë. Ata kanë kërkuar më shumë ndihma për të varfrit.

Brazili ka regjistruar gati 550 000 vdekje të lidhura me koronavirus.

Kjo shifër e viktimave është tejkaluar vetëm nga Shtetet e Bashkuara që kanë regjistruar mbi 610 000 persona të vdekur, ndonëse këto të fundit kanë 120 milionë më shumë banorë sesa Brazili. (Rel)

Belgjika përmblytet sërish nga shiu

BRUKSEL, 25 KORRIK- Shumë stuhi kanë goditur të shtunën Belgjikën, duke shkaktuar vërshime dhe rrëshqitje dheu. Ky njoftim vjen pak ditë pasi shira të rrëmbyeshëm kanë rezultuar me viktime në këtë shtet. Provincat Namur dhe Vallun Brabant janë goditur më së keqi.

Makinat janë tërhequr nga uji i madh më 24 korrik, disa prej të cilave kanë bllokuar linjat e trenit në qytetin Dinant.

Agjencia e lajmeve "Belga" ka raportuar se trafiku hekurudhor është pezulluar në disa zona prej kur kanë nisur vërshimet më herët gjatë këtij muaji.

Zjarrfikësit janë angazhuar për t'iu ndihmuar më të prekurve nga vërshimet, të cilat zëvendëskryetari i qytetit Dinant, Robert Closset, i ka përshkruar më të keqija se ato të javës së kaluar.

Qendra belge për kriza ka lëshuar një paralajmërim, duke thënë se moti i keq pritet të zgjasë për disa ditë. Belgjika ka regjistruar 36 viktime si pasojë e vërshimeve paraprake të cilat kanë shkatërruar edhe disa pjesë të Gjermanisë, Luksemburgut dhe Holandës. Numri i të vdekurve në këto shtete ka shkuar në mbi 210, derisa dëmet ekonomike besohet se prekin miliarda euro.



Shkon në 136 numri i viktimave nga rrëshqitjet e tokës në Indi



NEW-DELHI, 25 KORRIK - Numri i viktimave nga rrëshqitjet e tokës për shkak të shirave të rrëmbyeshëm që goditën shtetin federal Maharashtra në Indinë perëndimore është rritur në 136. "Deri natën e

kaluar, 136 persona humbën jetën në incidente të lidhura me rrëshqitjet e dheut", ka deklaruar ministri i Ndihmës së Shtetit dhe Rehabilitimit, VijayWadettiwar. Ai ka thënë se situata është nën kontroll dhe

se po bëhet çdo përpjekje për t'iu ofruar njerëzve ndihmën e nevojshme. Zyrtarët e autoriteteve indiane thonë se më shumë se 1 000 persona po kërkohen në shtetin federal Maharashtra.

Kur mund të jenë shqetësuese simptomat pas vaksinimit?



PRISHTINË, 25 KORRIK - Një plogështi e kishte kapluar Sinan Palojën në ditën kur e mori vaksinën kundër Covid-19, sëmundjes që shkakton koronavirusi. Përveç kësaj, ai tha se nuk kishte përjetuar ndonjë simptomë tjetër si pasojë e imunizimit me vaksinën e kompanisë “Pfizer/BioNTech”. “Ditën e parë kam pasur pak plogështi, përndryshe nuk kam pasur temperaturë”, shpjegon ai. Plogështia së bashku me disa simptoma të tjera janë ndër shqetësimet kryesore dhe më të shpeshta të personave që marrin vaksinën, sipas Ministrisë së Shëndetësisë. “Deri më tani shumica e rasteve të raportuara janë për efekte të lehta anësore si ethe, temperaturë, dhimbje krahu, kokëdhimbje, plogështi”, kanë thënë zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë për “Radion Evropa e Lirë”. Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe organizata të tjera të shëndetit kanë bërë me dije se marrja e vaksinave është e sigurt dhe efektet e mundshme anësore nuk e tejkalojnë rrezikun nga mosmarrja e vaksinës, përkatësisht pasojat që mund t’i kenë personat e prekur me

Covid-19.

Një qytetare që deshi të qëndrojë anonime ka treguar se ajo nuk kishte pasur fare simptoma pas vaksinimit, ndërsa babai i saj 52-vjeçar e kishte përjetuar më rëndë. “Lodhje, kokëdhembje. Ka zgjatur disa ditë”, tha ajo. Në Kosovë momentalisht jepen vetëm vaksinat e kompanive “Pfizer/BioNTech” dhe “AstraZeneca”, të dyja këto vaksina të aprovuara nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) dhe ajo amerikane (FDA). Aktualisht në Kosovë është duke u zhvilluar vaksinimi masiv i qytetarëve, që do të thotë se të gjithë personat mbi 18 vjeç mund të regjistrohen për t’u imunizuar nëpërmjet vaksinimit. Deri të shtunën në Kosovë janë dhënë mbi 356 000 vaksina. Qeveria e Kosovës ka thënë se e ka prioritet vaksinimin e 60 për qind të qytetarëve deri në fund të vitit.

Cilat mund të jenë efektet më të rënda pas vaksinimit?

Përveç simptomave të lehta që mund të shfaqen te të gjithë njerëzit që e marrin vaksinën

kundër koronavirusit, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, ekzistojnë edhe disa efekte anësore më të rënda të cilat janë të rralla. “Efektet e tjera anësore janë shumë të rralla: mpiksja e gjakut, miokarditi, perikarditi”, thuhet në deklaratën e Ministrisë së Shëndetësisë.

Shqetësimi mund të ekzistojë edhe për ndonjë reaksion të mundshëm alergjik. Sipas Ministrisë, këto efekte anësore janë një ndër arsyt kryesore pse ka pasur ngurrim të qytetarëve për t’u vaksinuar. Shumë shtete të BE-së kanë vendosur kufizime në përdorimin e vaksinës “AstraZeneca” si dhe vaksinës “Johnson & Johnson” për shkak të shqetësimeve për mpiksje të gjakut. Deri më tani probabiliteti i këtyre rasteve ka qenë katër raste në një milion të vaksinuar.

Në një përgjigje për “Radion Evropa e Lirë”, Ministria e Shëndetësisë në Kosovë ka thënë se “nga raportet e paraqitura në Komisionin për Hulumtimin e Efekteve Anësore Pasvaksinale nuk ka pasur raporte të mpiksjes së gjakut”.

Nëpër qendra të vaksinimit në vend është vendosur sistemi i

kontrollit, ku qytetarët presin disa minuta pas vaksinimit për t’u siguruar se do të kenë ndihmë mjekësore të menjëhershme në rast të ndonjë efekti të rëndë apo reaksioni alergjik.

Gjithashtu, qytetarët furnizohen me dokumente ku janë përmbajtjet e secilit lloj të vaksinës që jepet në Kosovë dhe ata mund të zgjedhin me cilin lloj do të vaksinohen.

A dallojnë simptomat nga lloji i vaksinës që merret?

Nga monitorimet deri më tani nuk është vërejtur që simptomat pas marrjes së vaksinës dallojnë nga lloji i vaksinës i cili merret. “Simptomat eventuale pasvaksinale janë pothuajse të ngjashme për secilën vaksinë”, thuhet në përgjigjen e Ministrisë së Shëndetësisë. Ata kanë bërë me dije se çdo qendër e vaksinimit është e pajisur edhe me formularin e raportimit të efekteve anësore eventuale pasvaksinale të cilat janë të obliguar t’i raportojnë në rast se shfaqen dhe të njëjtat ia përcjellin Komisionit për Hulumtimin e Efekteve Serioze Pasvaksinale.

Deri më tani ministria ka bërë

me dije se personat e vetëm që duhet shtyrë vaksinimin janë njerëzit që kanë çfarëdo sëmundje akute, mundësisht derisa të shërohen. “Kjo vlen edhe për Covid-19, por edhe për sëmundjet e tjera. Megjithatë, njerëzit me sëmundje kronike dhe simptoma të qëndrueshme mund të marrin vaksinat (p. sh., personat me sëmundje obstruktive kronike të mushkërive)”, thuhet në njoftim. Ndërkaq vaksinimi i shtatzënave rekomandohet “në rastet kur përfitimet e vaksinimit për shtatzënë tejkalojnë rreziqet e mundshme”.

Nëpër botë po shpërndahet me shpejtësi varianti i ri Covid-19 i quajtur “Delta”. Vaksinimi masiv po shihet si zgjidhje e vetme për të evituar një valë të re të infektiveve masive me fillimin e sezonit të vjeshtës. Një studim i ri në revistën mjekësore “New England Journal of Medicine” ka thënë se dy doza të vaksinës “Pfizer/BioNTech” ose “AstraZeneca” kundër koronavirusit janë efektive kundër variantit më ngjites “Delta”, aq sa janë kundër variantit të mëparshëm dominues “Alfa”.



SOT DITË ZIE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PAS AKSIDENTIT ME AUTOBUS NË KROACI
QË LA TË VDEKUR DHJETË PASAGJERË DHE MBI 40 TË LËNDUAR

Sot ditë zie në Kosovë

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka shpallur të hënën ditë zie shtetërore, pas aksidentit me autobus në Kroaci, ku mbetën të vdekur dhjetë pasagjerë (nëntë bashkatdhetarë dhe njëri nga shoferët e autobusit), kurse mbi 40 të lënduar, 15 prej tyre në gjendje të rëndë shëndetësore. Autobusi me targa të Kosovës që barte 67 pasagjerë ka dalë nga rruga në autostradën afër Sllavonski Brodit në Kroaci, rreth orës 6:00 të mëngjesit të së dielës. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD) ka njoftuar se të vdekurit janë bashkatdhetarë të cilët kanë qenë duke udhëtuar në linjën e rregullt Frankfurt - Prishtinë

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 25 KORRIK - Dhjetë persona kanë vdekur dhe mbi 40 të tjerë janë lënduar të dielën pas daljes nga rruga të një autobusi me targa të Kosovës, në autostradën afër Sllavonski Brodit në Kroaci. Në këtë autobus ishin 67 pasagjerë.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD) në Kosovë ka njoftuar se të vdekurit janë bashkatdhetarë dhe një nga shoferët e autobusit të cilët kanë qenë duke udhëtuar në linjën e rregullt Frankfurt - Prishtinë. Përveç 10 të vdekurve, 44 persona janë lënduar, kurse 15 prej këtyre në gjendje të rëndë shëndetësore, ka njoftuar kjo ministri. "Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë e angazhuar në orët në vazhdim për t'u dalë në ndihmë qytetarëve

të lënduar dhe për t'u asistuar bashkatdhetarëve dhe familjarëve të tyre në të gjitha procedurat e nevojshme", është thënë në njoftimin e MPJD-së. Kjo ministri ka ngushëlluar familjarët e viktimave dhe u ka uruar shërim të shpejtë të lënduarve.

Zëvendësprokurori i Shtetit Komunal, Sllavko Pranjiq, ka thënë se shoferi, i cili është gjetur në vendin e ngjarjes, është arrestuar ndërkohë. "Shoferi është arrestuar nën dyshimin për drejtim të automjetit në mënyrë jo të duhur. Shkaqet e daljes nga rruga të autobusit do të përcaktohen kur të merren provat", ka thënë ai.

Pranjiq ka thënë se përgjatë dëshmisë së tij shoferi ka thënë se ka rënë në gjumë për një çast, "por ne do të përcaktojmë gjithçka më vonë", ka thënë

Pranjiq. Ministri kroat i Shëndetësisë, Vili Berosh, ka thënë në se vendin e aksidentit në autobus kanë qenë 15 të mitur, prej të cilëve një vajzë e lënduar rëndë.

Shefi i policisë së trafikut në Sllavonski Brod, Franjo Galiq, u ka thënë gazetarëve se policia ka marrë raportime më 25 korrik në orën 6:20, se një autobus ka dalë

nga rruga. "Pas mbërritjes në vendin e ngjarjes, është përcaktuar se ishte një autobus me targa të Kosovës i cili po udhëtonte në linjën e rregullt Frankfurt - Prishtinë", ka thënë Galiq.

Reagojnë liderët e institucioneve të Kosovës: Dhimbja është e papershkrueshme

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka quajtur tragjik lajmin për aksidentin. "Me zemër e me shpirt sot jemi me familjet që humbën më të dashurit në këtë tragjedi. Dhimbja është e papershkrueshme e humbja shumë e madhe. Ngushëllime të sinqerta për të gjithë! Shteti i Kosovës do të jetë përkrah familjeve të atyre që humbën

jetën, sikurse edhe të lënduarve të cilëve u dëshiroj shërim të shpejtë", ka thënë Osmani.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka reaguar në lidhje me këtë aksident tragjik. "Në mëngjesin e sotëm ka ndodhur një aksident i rëndë në autostradën Slavonski Brod në Kroaci. Autobusi ishte i linjës Frankfurt - Prishtinë, i mbushur me bashkatdhetarë. Duke u lutur që të ketë sa më pak viktima, bashkëndiejmë të pikëlluar me familjarët e bashkatdhetarëve që u aksidentuan në këtë ngjarje të trishtë", ka shkruar Konjufca në llogarinë e vet në "Facebook". Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se me pikëllim të thellë e ka marrë lajmin për aksidentin tragjik në Kroaci. "Me pikëllim të thellë morëm lajmin për aksidentin tragjik në Kroaci, të një autobusi me targa të Kosovës. Ndonëse ende nuk kemi konfirmime zyrtare për detajet, lutemi të ketë sa më pak të vdekur e sa më shpejt të shërohen të lënduarit. Ministri ynë i Punëve të Brendshme po nisët për Kroaci, ndërkaq drejt vendit të aksidentit, tek autostrada e Sllavonski Brodit, tashmë është nisur ambasadori ynë në Zagreb", ka treguar Kurti në një shkrim të publikuar në "Facebook".

Për aksidentin tragjik në Kroaci



kanë reaguar edhe liderët e partive opozitare, duke u shprehur ngushëllime familjarëve të viktimave. Në lidhje me këtë aksident ka reaguar edhe presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama. “Me trishtim të thellë përçolla lajmin e rëndë për aksidentin tragjik në Kroaci. Ndaj dhembjen e madhe me familjet e viktimave dhe ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta. Pasagjerëve të lënduar ju uroj shërim të shpejtë!”, ka shkruar Meta në llogarinë e vet në “Facebook”.

Kroacia i shpreh ngushëllime Kosovës

Zyrtarët më të lartë shtetërorë në Kroaci kanë ngushëlluar familjarët e viktimave, ndërsa të lënduarve u kanë dëshiruar shërim të shpejtë. Presidenti kroat Zoran Millanović ka

shprehur ngushëllime për familjet e pasagjerëve të vdekur, derisa ka thënë se është me autoritetet dhe popullin e Kosovës në këtë çast të vështirë për ta. “U uroj shërim të shpejtë pasagjerëve të lënduar!”, ka thënë ai në “Facebook”. Ndërsa kryeministri i Kroacisë, Andrej Plenković, ka shkruar në “Twitter” se me trishtim të madh e ka marrë lajmin për incidentin me autobus me targa të Kosovës. “Bashkëndiejmë me familjet e viktimave, autoritetet dhe popullin e Kosovës, të cilëve u shprehim ngushëllime të thella. Shpresoj që pasagjerët e lënduar të shërohen”.

Kurse ministri i Jashtëm kroat, Gordan Gërliq Radman, ka thënë se ka biseduar me ministren për Punë të Jashtëm dhe Diasporë në Qeverinë e Kosovës, Donika Gërvalla, për t'i shprehur ngushëllime popullit të Kosovës dhe familjeve të viktimave.

Raporti i policisë kroate për aksidentin tragjik

Departamenti i Policisë së Qarkut Brod-Posavina në Kroaci ka lëshuar një deklaratë duke dhënë hollësi për rrethanat e aksidentit tragjik me autobus në autostradën afër qytetit Slavonski Brod. Policia kroate ka njoftuar se në orën 6:19 të mëngjesit të së dielës ka marrë raportin e aksidentit në autostradën A3 Bregana-Lipovac, në korsinë jugore, afër qytetit Slavonski Brod. Në deklaratën e policisë është përshkruar se si autobusi me 67 pasagjerë dhe dy shoferë doli nga autostrada. “Gjatë hetimit, në prani të avokatit të shtetit, policia përcaktoi se aksidenti i trafikut ndodhi në atë

mënyrë që një shtetas 52-vjeçar i Kosovës po voziste një autobus me dokumente dhe targa regjistrimi të Kosovës në korsinë jugore A3 Bregana-Arruga nga perëndimi në lindje. Duke arritur në kilometrin e 211 të autostradës, shoferi nuk lëvizi në mes të korsisë së shënuar, por drejtoi automjetin në zonën me bar, më pas autobusi u përmbys në anën e tij. Anëtarët e brigadave të zjarrfikësve dhe ekipet e tjera emergjente ndërhyjnë në vendin e ngjarjes për t'i marrë trupat e të aksidentuarve”, thuhet në deklaratën e policisë kroate.

Të lënduarit u transportuan në spitalin rajonal në Slavonski Brod,

ku po mbahen për trajtim të mëtejshëm mjekësor. “Në orën 10:40, shoferi 52-vjeçar i autobusit u arrestua dhe, pas një hetimi penal, do t'i dorëzohet mbikëqyrësit të kujdestarisë së Administratës së Policisë Brod-Posavina me një kallëzim penal për dyshimin e kryerjes së një veprë penale sipas nenit 227 të Kodit Penal ‘Shkaktimi i aksidentit të trafikut’, më pas në zyrën e avokatit shtetëror kompetent”, ka njoftuar policia. Si pasojë e aksidentit, trafiku në këtë pjesë të autostradës u mbyll në orën 7:40 dhe u lëshua një korsi e saj në orën 11:35, ka njoftuar policia kroate.

Flasin dy nga të mbijetuarit e aksidentit në Kroaci: Gjithçka ndodhi brenda një minute

Në një linjë të drejtpërdrejtë për RTK-në, dy nga personat që i kanë mbijetuar këtij aksidenti kanë treguar se si ka rrjedhur e gjithë ngjarja. “Ka ndodhur brenda një minute. Vetëm kemi parë se është rrëzuar autobusi. Kemi parë kiamet. Shoferët kanë qenë në gjumë. Ata janë ndërruar kohë pas kohe”, ka thënë një prej të mbijetuarve. Një tjetër pasagjer i cili ishte brenda autobusit që u aksidentua, tregoi se të lënduarit janë mirë. “Autobusi ka shkuar zvarrë rreth 100 metra. Të lënduarit janë më mirë”, ka pohuar edhe një prej të lënduarve.



Kurti dhe disa ministra nisen drejt Kroacisë

Qeveria e Kosovës ka njoftuar se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është nisur të dielën drejt Kroacisë, bashkë me disa ministra. “Së bashku me kryeministrin kanë udhëtuar edhe zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtëm dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia dhe shefi i stafit të kabinetit të presidentes së Kosovës, Blerim Vela”, është thënë në njoftimin e kryeministrit.



Drejtorët komunalë të arsimit kërkojnë që mësindhënësit të vaksinohen

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 KORRIK - Kolegjiumi i Drejtorëve Komunalë të Arsimit në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), duke pasur parasysh rrezikun që mund të paraqesë përkeqësimi i situatës me përhapjen e virusit Covid-19, ka bërë thirrje që të gjithë mësindhënësit që do të përfshihen në procesin mësues për vitin e ri shkollor 2021/22 të vaksinohen. Sipas tyre, vaksinimi gjithëpërfshirës do të sigurojë fillim dhe mbarëvajtje të sigurt të procesit mësues dhe do ta mundësonte ndjekjen e procesit shkollor në kushte më normale për nxënësit. "Duke pasur parasysh që mësindhënësit dhe mësimmxënësit janë shumë të rëndësishme të zhvillohen pa pengesa, vaksinimi do të



mundësonte që fillimi dhe vazhdimi i vitit shkollor të zhvillohet në kushte më të volitshme si për mësindhënësit ashtu edhe për nxënësit", është thënë në komunikatën për media të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Kolegjiumi i Drejtorëve Komunalë të Arsimit në kuadër të AKK-së ka bërë thirrje për mobilizim në kohën e mbetur para fillimit të vitit të ri shkollor që i gjithë personeli përfshirë në arsim të vaksinohet. "Shpresojmë që numri i

25 raste të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka regjistruar të dielën 25 raste të infektimit me koronavirus pas testimit të 2 102 mostrave. Përgjatë 24 orëve të fundit nuk është regjistruar asnjë viktimitë. IKShPK-ja ka njoftuar se më 25 korrik është shëruar një pacient nga sëmundja Covid-19, ndërsa raste aktive janë 161. Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë

regjistruar 108 017 pacientë me këtë virus. Prej këtyre, 2 265 kanë vdekur. Në Kosovë tashmë ka nisur programi i vaksinimit masiv kundër koronavirusit. Në këtë vend ka vaksina të prodhuesve "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZenca". Në 24 orët e fundit ndonjërin nga këto vaksina e kanë marrë 1 149 persona. Numri i personave të vaksinuar me të dyja dozat e vaksinave ka shkuar në 108 700, ndërsa shifra totale e vaksinave të dhëna është 357 920.

mësindhënësve të vaksinuar të rritet në mënyrë që të sigurohet mospërhapja e virusit. Bëjmë

thirrje që punëtorët arsimorë të vaksinohen", është theksuar në komunikatën e AKK-së.

Komandanti i FSK-së viziton Gardën Kombëtare të Iowas

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Në vazhdim të vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka vizituar Gardën Kombëtare të Iowas. Gjatë kësaj vizite është takuar me komandantin e Gardës Kombëtare të Iowas, gjeneralmajor Ben Corell, me të cilin kanë diskutuar për avancimin e partneritetit ndërshtetëror që Kosova ka me këtë shtet të ShBA-së. Gjeneral Rama ka falënderuar gjeneralin Corell për mbështetjen dhe bashkëpunimin për një dekadë për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së. Në veçanti, ai çmoi lart ofrimin e mundësisë historike të zbakimit të ushtarëve

të FSK-së së bashku me gardën e Iowas në misionin paqeruajtës dhe stabilitetit në Kuvajt. Gjithashtu, të dy gjeneralët diskutuan për avancimin e këtij partneriteti, për zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta në funksion të ngritjes së ndërveprueshmërisë dhe aftësive ushtarake për pjesëmarrje efektive edhe në zbakimet dhe misionet e tjera të përbashkëta paqeruajtëse. Gjatë kësaj vizite gjeneral Rama ka vizituar stërvitjen fushore të Gardës Kombëtare të Iowas, ku ishin të integruar edhe pjesëtarët e FSK-së, të cilët u njoftuan nga afër me aftësitë dhe kapacitetet operacionale logjistike dhe ato ajrore të Gardës Kombëtare të Iowas.



Arrestohen shtatë persona për përfshirje në veprën penale "kontrabandë të emigrantëve"



PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Njësitë policore kufitare gjatë vëzhgimit të terrenit në Vermicë, konkretisht nën urën e parë të autostradës, pikërisht te shkycja e parë e autostradës, kanë vërejtur lëvizje të dyshimta. Aty kanë ardhur gjashtë vetura "Taxi", kurse nga shkurret dhe mali kanë dalë dhe kanë hyrë në automjete disa emigrantë. Patrullat policore që ishin në

vëzhgim menjëherë kanë intervenuar dhe gjashtë automjete janë shoqëruar në Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Kufirit-Vermicë. Për rastin janë njoftuar hetuesit policorë të Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare-Perëndimi Gjakovë, Drejtoria e Migrimit dhe prokurori i shtetit. Zyrtarë policorë nga

Drejtoria për Migrim kanë filluar të merren me pesëmbëdhjetë emigrantë të ndaluar në këtë rast. Pas intervistimit, me aktvendim të prokurorit, janë dërguar në mbajtje shtatë të dyshuar nga Kosova për përfshirje në veprën penale "kontrabandë të emigrantëve", po ashtu janë sekuestruar edhe gjashtë vetura të përfshira në rast.

DnV-ja: Zgjedhjet lokale të karakterizohen nga koalicionet programore dhe me më shumë gra në lista

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 KORRIK - Përfaqësues të rrjetit të organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" (DnV) ka mbajtur një konferencë për media gjatë së cilës është publikuar një vlerësim "ex-ante" i zgjedhjeve lokale të 17 tetorit.

Qëllimi i këtij adresimi të DnV-së është që të nxitet një klimë diskutimesh në publik lidhur me çështjet që duhet të adresohen në prag të zgjedhjeve. "Modeli i fushatës zgjedhore, të cilin e kemi hasur zakonisht në zgjedhjet lokale, ka favorizuar kandidatin për kryetar të komunës, duke anashkaluar kandidatët për kuvendet komunale. Fillimi i aktiviteteve të fushatës zgjedhore para fillimit zyrtar të saj ka krijuar përparësi konkurruese të disa subjekteve, në kundërshtim me frymën e garës së barabartë zgjedhore. Po ashtu, fillimi i parakohshëm i fushatës u ka mundësuar subjekteve të caktuara që t'i shtrembërojnë shpenzimet reale, duke raportuar vetëm ato të bëra gjatë fushatës zyrtare, që paraqesin vetëm 'majën e ajsbergut', është bërë me dije në komunikatën e DnV-së.

Në këtë njoftim theksohet se, përveç periudhës së parafushatës, financimi dhe deklarimi i shpenzimeve mbeten çështje problematike edhe gjatë fushatës. "Kandidatët në garë zgjedhore lokale, në mungesë të detyrimit ligjor, nuk kanë publikuar të hyrat dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatës, duke cenuar transparencën e procesit dhe parimin e garës së barabartë zgjedhore. Karakteristikë e diskursit të fushatës zgjedhore ka qenë riciklimi i premtimeve nga zgjedhjet paraprake për tema që shpesh nuk janë fare në kompetencë të komunave. Platformat në të shumtën e rasteve, përveç që publikohen shumë vonë, janë më shumë deklarata politike shabllone sesa ofertë serioze për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve", theksohet në këtë komunikatë.

Sipas DnV-së, kandidaturat zakonisht sillen vetëm rreth të parit të komunës duke mos ofruar asnjë informatë lidhur me ekipin apo kabinetin qeverisës që do të



përfshihet në zbatimin e këtyre platformave. "Në anën tjetër, korrupsioni zgjedhor, i shpërfaqur përmes përdorimit të resurseve publike për qëllime të fushatës, ka qenë një prej fenomeneve më negative të zgjedhjeve. Kjo është tipike për pjesën më të madhe të komunave, por në raste të caktuara evidentohet mobilizim i resurseve shtetërore në funksion të fushatës së kandidatëve të partisë në pushtet", thuhet në komunikatën e DnV-së.

Sipas rrjetit të organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve, pjesëmarrja e grave duket të jetë gjithnjë e më simbolike në proces zgjedhor, e manifestuar përmes deficitit të kuadrove të grave në lista zgjedhore, sidomos si bartëse të listave, por edhe hapësirës dhe mbështetjes financiare që grave kandidatë u ofrohet gjatë fushatës. "Në të gjithë historikun e zgjedhjeve lokale në Kosovë, vetëm një grua ka arritur të zgjidhet kryetare e komunës në vitin 2013, ndërsa numri i kandidaturave të grave është shumë simbolik, mesatarisht vetëm pesë gra kandidatë në 100 kandidatë. Edhe si bartëse të listave gratë janë të përfshira shumë pak. Në dy palë zgjedhjet e fundit vetëm rreth 40 gra kanë

qenë bartëse të listave, nga qindra bartës sa ka pasur gjithsej. Nënepërfaqësimi i grave është evident edhe në trupat menaxhuese të zgjedhjeve, ku subjektet politike ende mbeten larg zotimeve të tyre për përfshirje të grave në shkallën prej 40-përqindësh", thuhet në këtë komunikatë.

Mediat tradicionale dhe ato sociale janë shndërruar ndër format kryesore të të bërit fushatë, posaçërisht gjatë proceseve të fundit zgjedhore. "Sidoqoftë, si rezultat i mosrespektimit në nivel të duhur të rregullativës ligjore, mediat shpeshherë shërbejnë si instrumente të promovimit partiak. Në aspekt të menaxhimit të zgjedhjeve, KQZ ka shënuar përmirësime të ndjeshme. Megjithatë, shumica e parregullsive të evidentuara gjatë procesit të votimit janë rezultat i trajnimeve jocalësore dhe joadekuate të komisionarëve. Si rezultat i trajnimeve të tilla, sidomos në raport me procesin e numërimit, kemi një përqindje të madhe të vendotimeve të cilat rinumërohen sërish. Po ashtu, puna e KQZ-së është shoqëruar nga politizimi i diskutimeve, që ka shkaktuar pengesa në mbarëvajtjen e punës së saj", është thënë në komunikatën e DnV-së.

Dhjetë rekomandimet e DnV-së për zgjedhjet lokale

1. Subjektet politike të arrijnë marrëveshje dhe koalicionet parazgjedhore në mënyrë që kandidaturat të jenë rezultat i koalicioneve programore e jo të bazuara në pazare pas raundit të parë zgjedhor.
2. Subjektet politike, sidomos ato që kanë pushtet në nivelin qendror apo atë lokal në komuna të caktuara, të mos përdorin resurset publike për qëllime të fushatës.
3. Subjektet politike të ndërtojnë platforma të qarta e konkrete për adresimin e problemeve të qytetarëve, dhe t'i publikojnë ato në formate të shkruara apo online.
4. Kandidatët t'i paraqesin të hyrat dhe shpenzimet e tyre të fushatës në kohë reale, si vlerë e shtuar e procesit.
5. Subjektet politike t'u ofrojnë grave më shumë mundësi kandidimi si bartëse të listave, si dhe për si kandidatë për pozitën e kryetarit të komunës.
6. Subjektet politike të mos mjaftohen me përmbushjen e kriterit minimal ligjor prej 30 për qind për kandidimin e grave për kuvendet komunale, por të avancojnë drejt aplikimit të modelit "zebër" në listat e kandidatëve, ku çdo i dyti kandidat

është i gjinisë tjetër. 7. Subjektet politike të ofrojnë përkrahje të barabartë financiare për të gjithë kandidatët, dhe ta bëjnë transparente mënyrën e shpërndarjes së tyre sidomos për kandidatet gra.

8. Trajnimet për anëtarët e KVV-ve duhet të jenë më cilësore, duke i testuar në mënyrë më rigorozë njohuritë e fituara të komisionarëve. Përmbajtja e trajnimeve duhet të reflektojë edhe seriozitetin e problemeve në elemente të caktuara, sidomos në numërim dhe plotësim të formularëve të rezultateve. Gjithashtu, KQZ të krijojë "lista të zeza" të komisionarëve bazuar në performancën e tyre.

9. Subjektet politike t'i përmbahen zotimit të tyre për përfshirje të grave në nivelin prej 40 për qind në trupat menaxhuese të zgjedhjeve, e madje ta avancojnë këtë përfshirje në proporcionin 50-50 për qind.

10. Komisioni i Pavarur i Mediave të bëjë monitorim sistematik të mediave gjatë fushatës zgjedhore lidhur me respektimin e rregulloreve në fuqi. KPM të monitorojë aktivitetin e subjekteve politike edhe në rrjete sociale.

Për tri ditë 400 bashkatdhetarë vizituan Kuvendin

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Kuvendi i Republikës së Kosovës për tri ditë radhazi ka mirëpritur bashkatdhetarë të cilët kanë shprehur interesimin ta vizitojnë institucionin më të lartë përfaqësues në Kosovë. Në

kuadër të aktivitetit "Kuvendi hap dyert për bashkatdhetarët" ky institucion është vizituar nga rreth 400 bashkatdhetarë të cilët janë pritur nga kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe deputetë të tjerë. Ata, po ashtu,

janë njoftuar për rolin dhe mënyrën e funksionimit të Kuvendit, për punën dhe angazhimet ditore të ligjvënësve, si dhe për aspekte të tjera të procesit legjislativ e të jetës parlamentare në përgjithësi.



Ujkani: Kosova vazhdon të përballlet me ambient jofavorizues për investimet e huaja

**EPOKA E RE**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 KORRIK - Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, Emrush Ujkani, ka thënë se tërheqja e investimeve të huaja vazhdon të mbetet ndër sfidat kryesore ekonomike në vendin tonë. Ujkani ka thënë për gazetën "Epoka e re" se edhe gjysma e dytë e këtij viti nuk po shihet se do të sjellë risi sa iu përket investimeve të huaja në Kosovë. "Investimet e huaja dhe rritja e pranisë së tyre në vendin tonë vazhdon të jenë një nga sfidat kryesore që ndërliken ngushtë me zhvillimin ekonomik të vendit. Edhe gjysma e vitit 2021 nuk është që ka sjellë ndonjë risi në këtë drejtim, por mbesim me shpresë që me stabilizimin e gjendjes së pandemisë dhe stabilitet të qëndrueshëm politik, të ndodhë diçka më mirë. Shpresat janë që në të ardhmen e afërt trendet të ndryshojnë edhe në raport me investimet e huaja në Kosovë", ka thënë Ujkani.

Sipas tij, klima e biznesit në Kosovë nuk është e favorshme, duke rekomanduar që, krahas sundimit të ligjit, të rriten edhe iniciativat fiskale dhe jofiskale. "Klima aktuale e të bërit biznes mund të konsiderojmë se nuk është më e mira. Kosova, krahas fuqizimit të sundimit të ligjit, ka nevojë të krijojë edhe iniciativat të ndryshme, qofshin ato fiskale dhe jofiskale, përmes të cilave do të krijoheshin kushte edhe më të mira për të bërë biznes, pse jo edhe për të tërhequr investitorë", ka deklaruar Ujkani. Në këtë bisedë Ujkani ka folur edhe për Gjykatën Komerciale. Ai ka shprehur skepticizëm se kjo gjykatë mund të sjellë risi në

ambientin e të bërit biznes. "Personalisht nuk e konsideroj Gjykatën Komerciale diçka të arritur dhe që Kosovës i ka munguar, apo që ka penguar procesin e sundimit të ligjit edhe në aspektet e drejtësisë komerciale. Ju e dini se një gjykatë e tillë veçse ka ekzistuar edhe më herët, ku në emër të reformës gjyqësore e shuan atë, kurse tash prapë po rikthehet. Nuk e di se në emër të cilës reformë tash po rikthehet e njëjta", ka thënë ai.

Sa i përket nismës për hartimin e Ligjit për Kriptoaluta, Ujkani ka thënë se kjo iniciativë është e mirëpritur por, sipas tij, duhet të ndiqen edhe rekomandimet që ka adoptuar Komisioni Evropian lidhur me regjimin e kryptoaseteve. "Si iniciativë ligjore ne si Këshill i Investitorëve Evropianë e mbështetim. Pra, e konsiderojmë më se të nevojshme për të pasur një siguri juridike edhe në aspektet që ndërliken me kriptoaluta. Mendoj se në këtë drejtim duhet të ndiqen edhe rekomandimet që ka adoptuar Komisioni Evropian lidhur me regjimin e kryptoaseteve", është shprehur Ujkani.

Ndërkaq sa iu përket sektorëve me më interes për investitorët e huaj, Ujkani ka thënë se sektori i minierave dhe energjisë ngelen me më së shumti interesim, përderisa ka përmendur vendet nga ku është interesimi më i lartë për të investuar. "Interesimi është në fushat energjisë, minierave, minerareve dhe prodhimit. Janë të interesuar kryesisht investitorë nga Gjermania, Franca, Zvicra, Austria, Holanda, Belgjika dhe Italia", ka treguar drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, Emrush Ujkani.

Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, Emrush Ujkani, ka thënë se tërheqja e investimeve të huaja vazhdon të mbetet ndër sfidat kryesore ekonomike për Kosovën. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se klima e të bërit biznes në Kosovë nuk është e mirë. Sipas Ujkani, krahas fuqizimit të sundimit të ligjit, vendi ynë ka nevojë të krijojë edhe iniciativat të ndryshme, qofshin ato fiskale apo jofiskale, përmes të cilave do të krijoheshin kushte edhe më të mira për të bërë biznes dhe për të tërhequr investitorë të huaj

Kapen në doganë rreth 75 mijë cigare, u tentua të shmanget taksa mbi 100 mijë euro

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Njësitë e Doganës, respektivisht ekipet e Antikontrabandës së Doganës, kanë ndaluar një furgon në të cilin kanë hasur cigare të kontrabanduara. Në njoftimin për media të Doganës theksohet se, pas ndalimit të këtij furgoni, janë gjetur cigare të llojit "Regina Red" dhe "Blue". "Sasia e cigareve në këtë rast është 75 mijë copë dhe ky është rasti i dytë brenda javës që kapen cigare të njëjta, pas rastit të parë prej 65 mijë copë. Me këtë veprim është arritur të parandalohet shmangja e taksave të detyrueshme mbi 100 000 mijë euro", është bërë me dije në njoftim.

Dogana e Kosovës ka theksuar se synon që në bashkëpunim me qytetarët ta mbrojnë interesin e shtetit, duke u pamundësuar kriminelëve të përfitojnë nga taksat e qytetarëve. "Andaj, mirëpresim bashkëpunimin me qytetarët e Republikës së Kosovës dhe mënyra më e sigurt është që të na kontaktoni përmes telefonit 0800 500 95, në 'Facebook' Dogana e Kosovës ose e-mail: info@dogana-ks.org. Me bashkëpunim efikas secili bëhet pjesë e luftës ndaj kriminit. Duke mbrojtur të hyrat ne i krijojmë më shumë mundësi zhvillimit të vendit", thuhet në njoftimin e Doganës.





ELIF SHAFAK

KUR BËHESH SHKRIMTAR?

Kur bëhesh shkrimtar? A është çasti kur mbaron variantin e parë të librit tënd të parë dhe, derisa ndihesh pak i shushatur dhe i humbur, mbase i zbrazur nga fjalët, vendos të dalësh për një shëtitje pasi ke kaluar javë dhe muaj të tërë mbyllur në shtëpi? A është çasti kur të telefonon agjenti yt letrar dhe të thotë se ke ofertë nga një botues i mirë dhe tingulli i atij zëri është kaq i jashtëzakonshëm dhe magjik sa që s'di as çfarë të thuash? A është hera e parë kur sheh një kopje të librit tënd në vitrinën e një librerie dhe ndalesh vetvetiu sapo e sheh, dhe shtangesh në vend, në trotuar, me një pamje të çuditshme në fytyrë, sikur të kesh parë një fantazmë? Apo atëherë kur për herë të parë takon lexues të cilët të afrohen ngadalë dhe në heshtje të kërkojnë autograf dhe ngrohtësia e zërit të tyre është kaq e vërtetë sa thjesht do t'i përqafosh? Apo është kur të pushton sërish një valë e re ankthi pasi ulesh në tryezën e shkrimit sepse s'ke asnjë ide se ku po të çon kësaj here libri që ke në proces? Të jesh shkrimtar është e barasvlefshme me të bërit shkrimtar, dhe ai proces i të bërit - leximi, të menduarit, vëzhgimi, të mësuarit, përpjekjet, procesi i zbulimit dhe dyshimit, të shkruarit, fshirja dhe rishkrimi, është një udhëtim i hapur. Në të thjeshtë, ti nuk arrin kurrë askund. Thjesht vazhdon.

Të gjitha romanet e mia të mëparshme i kam shkruar në gjuhën turke. Asokohe jetoja në Stamboll. Pasi u zhvendosa në metropol, në të njëzetat, kisha marrë me qira një apartament të vogël, të ndriçuar dobët, afër sheshit Taksim, apartament kaq të vogël sa s'arrita të vendosja një divan në sallonin i cili në të njëjtën kohë shërbente edhe si dhoma

ime e ndenjes. Ishte një nga lagjet më kozmopolite në qytet - një rrugë e quajtur Kazanci Yokusu, Rruga e Zanatçinjeve të Kazanit. Atje i shkrova librat, në një tryezë të improvizuar pranë dritares, duke parë të kalonin shitësit ambulantë, duke dëgjuar tingujt e tavëllit nga çajtorja në anën tjetër të rrugës. Për habinë time, pas çdo libri të ri që shkrova, gjeta lexues të rinj dhe, pak nga pak, njëfarë suksesi. Pasi mbarova romanin me titullin Magjepsja, pata një ofertë të shkëlqyeshme nga një botues i respektuar dhe kuptova se mund të lëvizja në një apartament pak më të madh në të njëjtën rrugë dhe kjo ide më shkaktoi panik sepse u ndjeva nën trysni dhe kështu vendosa për të lënë jo vetëm apartamentin tim, por edhe Stambollin, madje edhe Turqinë për ca kohë.

Shkova në Boston, në kolegjin Mount Holyoke, me një bursë për gratë artiste dhe shkrimtare nga pjesë të ndryshme të botës. Për një vit do të hulumtoja për një temë të miratuar nga departamenti dhe do të merrja pjesë në diskutime akademike dhe aktivitete shoqërore. Në vend të kësaj, pjesën më të madhe të kohës e kalova duke lexuar në bibliotekën madhështore gotike të universitetit, e cila për mrekulli ishte e hapur 24 orë gjatë gjithë javës, përveç ditëve kur ishin festat kombëtare. Disa pjesë të bibliotekës mbusheshin plot me studentë që përgatiteshin për provimet dhe disa pjesë të tjera ishin gati përherë bosh, prandaj aty gjeta strehë. Shkoja aty vazhdimisht gjatë ditëve të javës dhe fundjavave; jashtë rritej trashësia e borës, kurse brenda bibliotekës pllakoste heshtja.

Ishte një zonjë e moshuar që bënte pastrimin e cila vuri re praninë time. Çdo ditë ndalej për

një bisedë të shkurtër, më pyeste çfarë po lexoja, dhe pse kaloja kaq shumë kohë aty. Megjithatë ajo s'e tha asnjëherë hapur, duke e ditur se çfarë shpirti të dhembshur kishte, mund ta kuptoja që ndihej pak e trishtuar për mua. Ishte e mirë dhe e mençur dhe ma kujtonte gjyshen.

I thashë se isha shkrimtare dhe kisha ardhur nga Stambollin. I thashë se kisha vendosur të shkruaj në anglisht tani e tutje dhe më trembte kjo zhvendosje e papritur, ky migrim nga e njohura e gjuhës time amtare tek e panjohura e një gjuhe të huaj.

"Mirë", - tha ajo. "Shkruaj në anglisht atëherë".

"Mendoni se mund ta bëj?" - e pyeta.

"Sigurisht që mundesh" - tha ajo me një buzëqeshje të sigurt. "Por duhet ta shikosh Oprahn".

S'e kisha idenë për çfarë po fliste. Nuk shikoja TV dhe si e huaj në ShBA, ende s'kisha zbuluar shfaqjet e Oprah Winfreyt, gjë që e bëra më vonë dhe absolutisht më pëlqyen shumë. Por atëherë s'e kisha idenë se për çfarë po fliste. "Por Oprah s'të fton nëse s'ke një histori për të rrëfyer", - tha ajo, duke tundur kokën e pakënaqur. Atëherë e kuptova se për të, të shkruaje dhe botoje një libër, s'do të thoshte domosdoshmërisht të kishe një histori. Mund të shkruaje një vëllim të madh ose dhjetë romane njëra pas tjetres dhe mund të mos kishe një histori.

Të kishe një histori ishte diçka më vetjake, më emocionale dhe e brendshme. Të ishe autor libri s'do të thoshte të kishe patjetër një histori ashtu si jo të gjithë ata që kishin një histori nuk ishin autorë të librave. Ajo më nxiti ta shikoja më nga afër zanatin. Po ashtu, gruaja në bibliotekë më bëri të kuptoj diçka thelbësore

për artin e rrëfimit dhe për këtë do t'i jem gjithmonë mirënjohëse.

Kur bëhemi shkrimtarë?

Nuk ka të bëjë me të pasurit e një libri me ballinë të bukur, të japësh autograf në librat e tu, të flasësh në festivale letrare, të marrësh pjesë në ngjarje publike... megjithatë e gjithë kjo është shumë e lidhur me thelbin e këtij udhëtimi për te lexuesi dhe ato kanë rëndësi. Por ka të bëjë me një histori që rreh thellë brenda dhomëzave të zemrës

tonë, e cila rreh fort dhe na lë netëve pa gjumë, duke na kërkuar që ta rrëfejme, duke na kërkuar që të lindë, duke na çjerrë me thonj mishin e trupit tonë, një histori më e fortë, më e mençur dhe, në fund të fundit, më e mirë se vetja jonë me të meta të rrënjosura thellë. Kjo është koha kur fillojmë të bëhemi shkrimtarë.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Përktheu: Granit Zela)

Ragip
GJOSHI



Rrapi i atdheut (Të gjithë dëshmorëve të të gjitha kohëve)

Si rrapi i gjatë përballë shtrojerave,
Ju shtatartët e atdheut tim qëndruat,
Sa herë pati nevojë atdheu im për ju,
Si rrapi shekullor përballë stuhive,
Ju që kishit mall për Shqipërinë tonë,
Ju që u plaste zemra për t' i bërë bashkë copat e saj...
E sot bufët, shpendkeqtë vijnë e bëjnë glasa mbi rrapin,
Mjeranët dëshirojnë t' i bëjnë qelbësirë gjethet e tij...
Rrapi i atdheut, madhërisht qëndron,
As rrufetë s' e çajnë,
Rrapi shekujve u qëndroi krenar
Atdheut tim i bën roje e hije,
Rrapi im përherë strehë e kombit,
Rrënjët tua janë thellë në nëntokën e atdheut tim,
Rrapi i vendlindjes sime tundet, po nuk shkulet dot!
Rrapi im dremit, por nuk fle,
Ai i bën atdheut hije përjetësisht.
Të gjithë dëshmorët e kombit tim janë si rrapin.



RRËFIME NGA ISH-I BURGOSURI DHE I MBIJETUARI I MASAKRËS
NË BURGUN E DUBRAVËS, NAIT HASANI

Liria ka emrin UÇK

Kalimi nga dhomat e ferrit në liri

Mbyllja e një tmerri e kalimi nëpër ferr. Sapo kaluam portën që ndanë dy botë, lamë prapa krahëve botën e tmerrit, të krimeve, të vrasjeve, të dhunës e të torturave çnjerëzore ndaj të burgosurve dhe ndeshëm botën e lirisë që sapo filluam teksa ecnim këmbë deri te autobusi. Dielli shkëlqeu me mirëseardhje me kushtet atmosferike të marsit. Ai diell na përqafoi me rrezet e tij duke na uruar mirëseardhje.

Autobusët sikur dukeshin ndryshe, sikur tregonin dashamirësi sepse nuk i kishin zinxhirët dhe prangat që na kishin lidhur sa e sa herë përuleshim në varg me pranga gardianët serbë, duke na transportuar sa andej e këndeje Serbisë si pengje lufte e të burgosur politikë. Autobusi ishte pa hekura, pa zinxhir. Ishte i butë në pamje e i ëmbël në mikpritje. Edhe shoferi ishte mikpritës, na uroi mirëseardhje dhe na uroi fat. E ndezi autobusin dhe sapo lëvizti nga vendi, i mbylli dyert.

Në ato çaste m'u afrua një djalë i ri, me një mikrofon në

dorë, me një laps e shikim të këndshëm. Mirë se erdhe, Nait! Urime lirim nga burgjet! Jam Sadik Zeqiri, gazetar i "Epokës së re" dhe bashkëvuajtës me ju. Kam dalë më herët nga burgu. Tani këtu jam në cilësinë e gazetarit dhe dua një deklaratë nga ju për burgun dhe daljen nga burgu. I falënderova të gjithë ata që kanë bërë çdo gjë për të na liruar nga burgjet. Po ashtu, i thashë se ardhja në Dubravë përsëri, në vendin ku na kanë vrarë gardianët, të burgosurit serbë, policia e ushtria serbe dhe militarët e paramilitarë serbë, për mua është e papranueshme, të na kthejnë në këtë burg, të na kthejnë kujtesën e tmerrin në kujtesën tonë. Nuk mund t'ia falë UNMIK-ut këtë që na ka sjellë në këtë burg. Të na kthejë në vendin e vrasjeve të të burgosurve shqiptarë nga shteti serb. Duke folur me Sadikun në këtë intervistë të shkurtër, nga dritarja pashë të mbledhur familjarë e bashkëfshatarë, të afërm, miq dhe shokë të mi bashkëlufetarë që kishte vite që s'i kisha parë. Autobusi u ndal.

U hapën dyert. Aparatet



fotografikë u hapën duke na fotografuar. Dhe unë zbrita së bashku me kolegët e burgut. Aty u përqafoam me nënën, me babën, me motrat dhe Fatmiren (ushtaren e parë të UÇK-së, tani gruan time). Një qytetar më kapi me duar dhe më ngriti përpjetë. U përshëndetëm me bashkëfshatarë e kushërinj. U përshëndetëm dhe u përqafoam me Rexhën, Rexhep Selimin, me Maxhupin, Lahi Brahimajn, me Bislimin, me Islamin e Naimin, Avdiun e plotë të tjerë. Kishte vite që s'i kisha parë. Kisha mall e dashuri t'i shihja. Kishim nisur një rrugë bashkë në luftën tonë me UÇK-në për çlirim të Kosovës dhe trojeve shqiptare, kishim nisur rrugën me dashuri e vetëdije për sfidat që kishim përpara. Kishim nisur rrugën që lirinë mund ta arrijmë me fitore të luftës sonë me gjithë sakrificat. Kishim nisur rrugën duke e ditur se edhe mund të vritemi e të biem në burgje. Kishim nisur rrugën e luftës për

të qëndruar në trojet tona, për ta mbrojtur atdheun. Për ta mbrojtur tokën tonë "den baba den" që na kanë lënë të parët. Me armët tona të rreshtuara në UÇK, ne i dolëm zot vendit në kohën e duhur, në çastin e duhur për ta realizuar ëndrrën shekullore - çlirim të atdheut. Në këtë rrugë tonin ishin në rrugë të njëjtë të interesave politike të faktorit strategjik ndërkombëtar, ShBA-së, NATO-s dhe BE-së që e arritën këta djem me UÇK-në gjatë këtyre viteve të luftës, prindërit tanë me gjithë shekujt bashkë nuk mundën ta bëjnë për shkak të rrethanave politike që nuk ishin në anën tonë. UÇK-ja shfrytëzoi mrekullisht rrethanat politike dhe finalizoi qëllimin politik dhe ushtarak: çlirim të Kosovës nga Serbia pa asnjë shekull shtypje e kolonizimi, vrasje e gjenocid. Edhe një herë përqafova Rexhën e Lahiun për ta hequr mallin dhe për t'i uruar për luftën, çlirim dhe lirinë e arritur. Në këtë

turmë të madhe njerëzish, secili duke u përshëndetur me njëritjetrin me mall, shpërthyen lotët e gëzimit që dukeshin nëpër faqet e tyre. Tashmë filluan të niseshin makinat, ta lënin atë hapësirë para burgut dhe të merrnin drejtimin e rrugëve të fshatrave e qyteteve të të ish-të burgosurve. Ne, pas përshëndetjeve, hipëm në makina. Në një makinë hipëm unë, Rexha, Lahi, Fatmirja dhe Islami (vëllai i Rexhës) që e voziste makinën. Planifikuam të shkojmë në Prekaz te varri i Adem Jasharit në fillim, pastaj në shtabin qendror të TMK-së në Prishtinë, pastaj për në Randobravë e Prizren. Makina ecte dhe ne bisedonim me Rexhën, Fatmiren e Lahiun, herë-herë përqafoheshim nga malli. Kishte vite që nuk ishim parë. Ishte zhvilluar luftë dhe ne kemi qenë në pozita të ndryshme. Ata në luftë, unë në burgje. Ata tregonin për shokët që kanë rënë në beteja, për heroizmat e shokëve në luftë etj., për betejat e Mujës, Myrtës, Naserit, për rëniet në fushëbetejë në mënyrë heroike duke luftuar ballë përballë me policinë e ushtrinë serbe.

Në bisedë e sipër mbërritëm në Skenderaj. U kthëm majtas dhe morëm përpjetë për Prekaz nga fabrika e municionit. Aty të bombarduara shtëpitë e para te Sait e Musë Jasharit (të vrarë nënën e babën aty në shtëpi). Makina ecte ngadalë. Makina u ndal. Në të djathtë shtrihet një fushë e madhe, në sfond të saj varrezat e renditura një pas një sipas moshës. U nisëm nëpër



trasenë e drunjte dhe u ngjitëm shkalleve. Përballë nesh ushtarë të uniformuar në roje nderi pranë varrit të Adem Jasharit. Mora buqetën me lule dhe e vendosa mbi varrin e Adem Jasharit. U zbrapsa pak, u bëmë bashkë me Rexhën, Lahiu, Bislimin, Besimin dhe një grup shokësh të dalë nga burgu e me familjarët dhe bëmë nderime me një minutë heshtje për të gjithë Jasharët. Bëmë homazhe te varrezat dhe në lëvizje duke parë moshat e tyre nga më i vjetri më afër tetëdhjetëvjeçar dhe deri te më i riu dhjetë vjeç. Një familje e tërë, burra, gra e fëmijë. Shabani, Hamza, Ademi, Hamiti të gjithë nga familja Jashari. Duke bërë homazhe në varreza, në kujtesë m'u shfaqën ato rrugë që kisha kaluar së bashku me Adem Jasharin, me Sahit Jasharin, me Sylejman Selimin, me Rexhep Selimin, për ta organizuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës

pashë odën që e kishin bombarduar, gjurmët dukeshin nga jashtë. Pashë dhe dritaret e shkatërruara nga granatat e policisë e ushtrisë serbe në luftë me Adem Jasharin dhe familjen Jashari. M'u shfaq edhe dhoma ku kisha fjetur në këtë odë sa e sa herë kur isha ilegal tek Ademi, bashkë me Rexhën dhe Sylën. U ndalen makinat para shtëpisë së re, konkretisht para odës së Jasharëve. Hapëm derën dhe u ngjitëm shkallëve. Në ballë të odës na pret baca Rifat në këmbë. Mirë se rdhe dhe urime lirim nga burgjet, më uroi baca Rifat. Ulemi dhe bisedojmë për sakrificën e Ademit e Hamzës dhe familjes Jashari. Tregova për takimin e fundit që kisha me Ademin e Rexhën më 17 janar 1997 te "Betonit i Polacit", përafërsisht edhe bisedat që kishim zhvilluar. Po ashtu, edhe rrugën që kishim bërë bashkë me bacën Rifat nga Tirana deri në Prekaz së bashku me Rexhën



sakrificën e dhënë për liri. Liria ka çmim, ka sakrifica, ka rënie të ushtarëve, por ka edhe fitoren. Atyre që kanë dhënë jetën për liri, respekt dhe nderime për jetë. Neve na duhet të ndërtojmë shtetin tonë dhe të mbrojmë atë me çdo kusht. Duke i falënderuar për pritjen e përzemërt, u përshëndetëm.

dhe mikrofonë. Këndonin dhe brohoritnin "UÇK, UÇK...". Nën tingujt e këngëve, valleve dhe brohoritjeve "UÇK, UÇK..." hipëm në binë. Sapo hipëm filluan krismat e pushkëve në shenjë gëzimi dhe përshëndetje me armë për ardhjen tonë. Mbjatën fjalë rasti Hazer Shala, drejtor i shkollës dhe dajë i babës. Një fjalë rasti mbajti dhe Bislim Zogaj, bashkëvuajtës imi nëpër burgje, anëtar i shtabit operativ të UÇK-së. Bislimi foli me tone gëzimi e mirëseardhje, me epitete për qëndresën nëpër burgje dhe sakrificën tonë. Pas tij mbajtën fjalime edhe bashkëluftëtarë të tjerë, Shaip Rexhepi, Milazim Hajredini etj. Edhe unë mbajta një fjalë rasti. I falënderova të gjithë për pritjen, për organizimin. Na pritën si heronj. I falënderova për luftën që kanë bërë në radhët e UÇK-së, për luftëtarët që kanë rënë dëshmorë, që kanë dhënë jetën për liri e çlirim të Kosovës. U thashë që pushkët e juaja janë bashkuar me pushkët e Adem Jasharit dhe janë këto pushkë që Kosovës ia kanë sjellë lirinë. Liria ka çmimin e shtrenjtë dhe ju keni paguar me gjakun tuaj. Liria ka emrin UÇK. Jam krenar me ju e luftën tuaj. Liria e çlirimit të vendit është pjesë e kontributit tuaj që ishit në radhët e UÇK-së dhe ndihmës së faktorit ndërkombëtar. Nën tingujt e

muzikës dhe brohoritjeve bëmë fotografi të shumta me bashkëfshatarë, shokë dhe miq. Bashkëfshatarët, në shenjë mirënjohje, na dhanë fotografinë e Adem Jasharit dhe të UÇK-së që e kishin përgatitur për mua. Mes përshëndetjeve me bashkëfshatarët e mi dhe të fshatrave përreth, marrim rrugën për Prizren, për banesën që ia kishin dhënë familjes, sepse shtëpinë në fshat policia dhe ushtria serbe e kishin djegur dhe bërë shkumb e hi në shenjë hakmarrje ndaj meje dhe bashkëvendësve të mi të angazhuar në luftën e UÇK-së. E kujtoj dhe kurrë nuk e harroj datën 27 mars 2002, ku i mbylla vitet e burgieve, të kaluara nëpër dhomat e ferrit e mes tmerrit e dhunës, përballë vdekjes, duke jetuar me vdekjen bashkë. Burgje të kaluara radhazi për katër herë i arrestuar e liruar, torturuar sa nga UDB-ashët serbë, sa nga UDB-ashët shqiptarë që ishin para viteve nëntëdhjetë, nga 30 nëntori i vitit 1983 deri më 27 mars 2002. Duke kaluar mbi dhjetë vjet burgje, sot kjo sfidë, me arritjen në shtëpi rreth orës 23:00 të natës, përfundoi. Përfunduan ndjekjet dhe burgosjet. Tashmë jam i lirë. Jetoj në liri. Liria ka emër - Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

(Fund)



Shtajner përshëndetet me familjarët e të burgosurve

dhe bërë planet për luftë guerile e frontale. Armiku largohet nga këtu nga trojet tona vetëm me barut dhe ne do t'i japim barut në çdo vend për ta larguar nga këtu për ta çliruar Kosovën nga Serbia, por na duhet strategji për ta arritur qëllimin tonë. Shihja varret dhe nuk gjeja në histori një rast të tillë qëndrese. Ky krim i tejkalon përmasat e një lufte gjenocidale. Ky ishte një krim i përmasave barbare, i një shteti barbar, një masakër në një familje që bëri shteti serb kundër një familje, duke vrarë pa mëshirë pleq e plaka, gra e fëmijë, 46 anëtarë të familjes Jashari. Nuk ka mendje njerëzore që ta përshkruajë këtë ngjarje me laps. Ndoshita këtë mund ta bëjë vetëm perëndia. Aty ishte, në ballë të Jasharëve, Adem Jashari, komandanti legjendar i UÇK-së me vëllanë, Hamzë Jasharin, me familjet e tyre. Historia nuk ka të ngjashëm rast të tillë, rast unik në mbrojtje të atdheut një familje e tërë. Herë-herë inkuadrimet e bisedave të Rexhës, të familjarëve më kthenin në realitet dhe në kohë. I lamë varrezat dhe morëm rrugën për te kulla e Jasharëve. Aty na priste baca Rifat Jashari. Aty rrugës

në vitin 1996. Pimë kafet e mirëseardhjes dhe për shkak të kohës së shkurtër që kishim, u përshëndetëm dhe i uruam shëndet njëri-tjetrit me bacën Rifat dhe familjen Jashari aty. Pas Prekazit morëm rrugë për Prishtinë. Rrugës përsëri biseda e përqafile sa me Lahiu e sa me Rexhën dhe me Fatmiren herë pas here e sa herë Islami na fliste për çorapët e teshat që kishim dashur t'i blejmë në Shkodër që më 1995, e i kisha shkuar në nerva atij në atë kohë kur isha me Rexhën në Tiranë për punë organizative të UÇK-së. Ai bënte të qeshnim me historitë e tij. Makinat u ndalën para shtabit të përgjithshëm të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK). Zbritëm nga makina. Në pritje komandanti i TMK-së, gjenerallejtënant Agim Çeku. Na priste edhe garda në rresht. U përshëndetëm me gjeneral Çekun dhe i bëmë gardës së nderit në pritje. Më pas shkua në zyrë të gjeneralit. Aty në tavolinë ishte Agimi (Çeku), Sylja (Sylejman Selimi) dhe ushtarë të TMK-së, ndërsa unë isha me Besim Ramën, Bislim Zogajn dhe disa të burgosur të tjerë. Bashkëbiseduam, duke i falënderuar ushtarët për luftën e

Hipëm në makina, pasi tashmë në TMK na zuri terri e u bë natë. Me makina morëm rrugën për në Randobravë dhe Prizren. Rrugës biseda e çmallje me njëri-tjetrit. Makina ecte nëpër kthesa e Islami që voziste në kujtonte që jemi në makinë. Morëm rrugën për fshatin tim, Randobravë. Në hyrje pashë gjurmët e granatimeve të rezervave të naftës të bodrumit në Krushë të Vogël. Në mure më thanë a po e sheh thënien e shkruar në ndërtesën e stacionit të trenit: Ku është Nait Hasani? Dhe qeshëm dhe thanë në makinë është Naiti.

Rruga për fshat ishte e pashtruar dhe me gropa të mbushura me ujë, por ishte e kalueshme për makina. Në hyrje të fshatit filluan boritë e makinave. Te shkolla pashë fshatarët e mi që kishin dalë të na pritnin. Kishin organizuar një pritje madhështore. Ishin renditur në radhë për të më përshëndetur. Fillova t'i përshëndes të gjithë një nga një, dorë për dorë. Pas meje ishte Fatmirja, nëna, baba, axha im dhe bashkëvendësi im Hasan Ferati, i cili ishte liruar edhe ky nga burgju. Në fund kishin vendosur një binë me fotografi





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Majlinda eliminohet nga Lojërat Olimpikë



PRISHTINË, 25 KORRIK - Kampionia e "Rio 2016", Majlinda Kelmendi, është eliminuar nga Lojërat Olimpikë, pasi ka humbur në ndeshjen e parë të dielën, në "Nippon Budokan", në kategorinë deri në 52 kilogramë. Kelmendi pësoi humbje shokuese nga hungarezja Reka Pupp. Një waz-ari i marrë në shënim të artë, bëri që Kelmendit t'i ndalet synimi për të fituar një tjetër medalje olimpikë. Natyrisht se ishte surpriza e madhe e xhudos deri tani, pasi mund të thuhet se të gjithë kanë pritur së paku medaljen e bronzit nga Majlinda. Ajo e ka përjetuar rëndë humbjen, pasi është parë teksa po largohej nga arena. Majlinda Kelmendi erdhi në Tokio si fituese e medaljes së artë olimpikë në Rio 2016, duke synuar ta përsërisë suksesin edhe në olimpiadën japoneze, që nuk ia doli. Trajneri Driton Kuka ka thënë se pavarësisht këtij eliminimi, Majlinda Kelmendi do të jetë gjithmonë kampione olimpikë, botërore dhe evropiane. "Krenaria e veprimtarisë time... Majlinda, të falënderoj për jetë! Do të jesh gjithmonë kampione olimpikë, botërore e evropiane! Sot mos u hidhëro, puna e sakrificës, djersa e gjaku që ke derdhur për veten tënde, për mua, familjet tona, popullin shqiptar, t'u ka shpërblyer gjatë karrierës. Mos u hidhëro, se e arta e Disit është e të gjithë neve dhe ekipit tonë. Mos u hidhëro sot, të lutem. Kokën lart se aq shumë gëzime i ke dhuruar popullit shqiptar! Zoti të ka shpërblyer punën tënde, lëndimet ishin sfida që aq shumë të munduan ty fizikisht e mua shpirtërisht. Kokën lart, Majlinda! Krenar me ty deri në frymën time të fundit", ka shkruar Kuka në profilin e vet në "Facebook".

Sot garojnë Akili dhe Nora

Sot (e hënë) do të paraqiten Akil dhe Nora Gjakova. Akili do të garojë në kategorinë deri në 73 kilogramë, teksa në raundin e parë do të përballlet me Ahmed Ayash nga Jemeni. Ai fillon garën rreth orës 04:00. Në anën tjetër, Nora Gjakova gjithashtu e nis garimin e saj nesër. Ajo në kategorinë deri në 57 kilogramë në raundin e parë do të jetë e lirë, kurse në të dytin do të përballlet me fituesin e duelit mes xhudistes austriake, Sabrina Filzmoser dhe xhudistes nga Holanda, Sanne Verhagen. Nora do ta fillojë garimin pas orës 05:00.



Distria Krasniqi, e artë në Lojërat Olimpikë Tokio 2020

PRISHTINË, 25 KORRIK - Distria Krasniqi ka arritur të shpallet kampione olimpikë në kategorinë (-48kg). Krasniqi në raundin e parë ishte e lirë, në raundin e dytë mposhti me Ippon brazilianen Gabriela Chibana, në çerekfinale mposhti me Ippon edhe kinezën nga Taipei, Chen-Hao Lin. Në gjysëmfinalet Krasniqi mposhti me Wazaari mongolen Urantsetseg Munkhbat. Distria në finale mposhti me Wazaari japonezen Funa Tonaki, ku u shpërblye me titullin Kampione Olimpikë, hera e dytë për Kosovën, prapë nga sporti i xhudos.

SHKURT

Shenjëtari Ibrahimimi eliminohet nga Lojërat Olimpikë

Drilon Ibrahimimi ka përfunduar garën e shenjëtari sportive në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". Shenjëtari i Kosovës ka arritur 608.8 pikë, që e renditën në vendin 46 të disiplinës 10 metra pushkë ajrore. Driloni u shpreh se rezultati i sotëm ishte më i miri për të, njëherësh rekord shtetëror. Të pranishëm për ta ndjekur dhe përkrahur garuesin tonë ishin edhe presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, drejtuesit e KOK-ut dhe përfaqësuesit nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Ambasada e Kosovës në Japoni.

Eliminohet xhudisti Cullhaj

Ka përfunduar aventura e xhudistit shqiptar Indrit Cullhaj në Lojërat Olimpikë teksa është mundur nga rivali nga Kosta Rika, Sanço Çinçilla. Edhe pse pretendimet ishin të mëdha për Cullhajn, xhudisti është eliminuar që në raundin e parë në duelin e zhvilluar në mëngjesin e sotëm në kategorinë 66 kilogramë. Pas përfundimit të ndeshjes Cullhaj pësoi një dëmtim, çka bëri që ekipi mjekësor të ndërhynte menjëherë në fushë. Sipas asaj që u raportua, nuk kishte probleme serioze për xhudistin shqiptar, por vetëm një lëndim në brinjë, duke e mbyllur me zhgënjim aventurën e tij në Tokio 2020.

Australianet vendosin rekord botëror në not

Është vendosur një rekord bote në not në ditën e dytë të garave në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". Stafeta australiane 4x100 metra krol në konkurrencë të femrave, ka thyer rekordin e botës duke e përfunduar garën për 3:29.69 minuta dhe siguruar medaljen e artë olimpikë. Ajo ka thyer rekordin e vet që e kishte vendosur në Lojërat e Komonuellthit në vitin 2018. Medaljen e argjendtë e fitoi Kanadaja, ndërsa të bronzitën ShBA-ja. Ndërsa notarja suedeze Sarah Sjöström ka vendosur rekord olimpik në 100 metra krol, duke notuar për 52.62 sekonda. Edhe pse pritej që nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës të kishte garë të ashpër për medalje, ato nuk ia dolën më shumë se të bronzitën. Në ditën e parë, ShBA-ja mbeti pa medalje, gjë që s'i kishte ndodhur që nga Lojërat Olimpikë në Munih në vitin 1972.

Eda Zeqiri fiton baterinë e saj, por nuk kualifikohet

Prishtinë, 25 korrik - Notarja e Kosovës, Eda Zeqiri, ka garuar sot në disiplinën 400 metra stil i

lirë në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". 16-vjeçarja ka fituar baterinë e saj, duke përfunduar

me kohë 4:38.02 minuta, kohë e pamjaftueshme për t'u kualifikuar në finale. Në

përgjithësi, Zeqiri zuri vendin e 22-të. Eda është garuesja më e re e ekipit olimpik të Kosovës.



Koemani kërkon nga Laporta ta mbajë Manajn në skuadër

BARCELONË, 25 KORRIK - Karriera e Rey Manajt ka marrë një kah komplet tjetër nga çfarë pritej. Tre golat në miqësoren kundër Gimnatic disa ditë më parë, dhe goli kundër Gironës ditën e djeshme, ka futur në mendime drejtuesit e Barcelonës për të ardhmen e sulmuesit të Kombëtares së Shqipërisë. Katalanasit kishin

menduar ta shitnin për të fituar një shumë të mirë parash, por paraqitja e mirë e Manajt ka bërë që drejtuesit të ndërrojnë mendje. Me Antonine Griezmann, Philippe Coutinho dhe Martin Braithwaite drejt largimit, në skuadër do të mbetet vetëm Sergio Aguero si sulmues qendror. E duke parë lëndimet

e shpeshta që pësoi argentinasi sezonin e kaluar, Barcelona nuk dëshiron që të mbetet pa një sulmues rezerv. Sipas mediave spanjolle, duke parë paraqitjen në rritje të Rey Manajt, trajneri Ronald Koeman i ka kërkuar presidentit Johan Laporta të mos e shesë sulmuesin shqiptar, por të mbahet si

element i rëndësishëm në skuadër. Madje mediat spanjolle shkojnë edhe më tej, duke e krahasuar Manajn me shokun e skuadrës Aguero, pasi pozicioni dhe lëvizshmëria në sulm është pothuajse e njëjtë. Lëndimi i djeshëm mund të favorizojë edhe më shumë 24-vjeçarin pasi asnjë skuadër nuk do të



blinte një futbollist të lënduar dhe Manaj mund të provonte sërish shanset te skuadra e parë e Barcelonës.

Buffoni: Ëndërroj Botërorin e Katarit

ROME, 25 KORRIK - Ndonëse në moshën 43-vjeçare, Gigi Buffoni nuk ka ndërmend të "varë dorezat në gozhdë", pasi është rikthyer te Parma me qëllim që të sjellë sërish emilianët në Serinë A, por në një intervistë për mediat italiane nuk e fsheh as synimin madhor për të qenë pjesë e Italisë në Botërorin e Katarit vitin e ardhshëm. "Mançini ka bërë diçka të jashtëzakonshme dhe për këtë meriton elozhe e komplimente. Unë jam 43 vjeç dhe për respekt të punës së trajnerit, nuk do të kandidohem asnjëherë, por Botërori më shërben për të ëndërruar, në të kundërt pse duhet të vazhdoj të luaj. Është thuar se sigurt që Mançini nuk do të më grumbullojë dhe me të drejtë, pasi ka tashmë lojtarët e tij, por unë duhet të mendoj që kam një Botëror përpara, në mënyrë që të motivohem edhe më shumë", u shpreh portieri legjendar italian. Ish-shoku i Buffonit te Juventus, Federico Chiesa, ishte një nga protagonistët e suksesit të Italisë në Kampionatin Evropian, ndërsa gardiani 43-vjeçar pranon se fillimisht ka qenë skeptik për aftësitë e sulmuesit anësor. "Donnarumma



dhe Chiesa ishin pa diskutim dy nga elementët më të spikatur të kësaj Italie. Kur Fede erdhi te Juve një vit më parë, nuk e mendoja se ishte kaq i fortë, por një vit aty i shërbeu për t'u rritur shumë. E patë ndaj Anglisë, që kur merrte topin, nuk e ndalte dot askush. Tregoi veten në një kompeticion të rëndësishëm, aty ku shumë futbollistë nuk ia dalin t'i nxjerrin në pah aftësitë e tyre", ka shtuar Buffoni.

Sezonin e fundit te Juventus, Giggittiu desh të punojë me Andrea Pirlon trajner, një ish-shok skuadre që u kritikua jo pak në aventurën e tij të

re në pankinë, megjithatë Buffoni e merr në mbrojtje dhe vlerëson punën e tij. "Përveç 3-4 muajve të parë, ku natyrisht pati disa vështirësi në menaxhimin e situatave, Pirlo u përshtat më pas shumë mirë dhe ishte një trajner i mirëfilltë. Mund të them se bëme një sezon mjaft pozitiv, ndonëse vinim pas nëntë titujsh kampion radhazi dhe natyrisht që pritshmëritë ishin më të mëdha", u shpreh Buffoni.

Me 43 vjet mbi supe, Buffoni nuk ka ende një datë se kur do të tërhiqet nga futbolli i luajtur, megjithatë pranon se kur të vijë ky vendim, nuk do të vuajë shumë, pasi do t'u përkushtohet pasioneve të tjera që i ka lënë pas dore. "Për momentin dua të ndihmoj Parmën të rikthehet në Serinë A. Tërheqjen nuk e mendoj për sa kohë që shoh se jam i aftë të bëj mirë punën time në portë. Nëse shoh që nuk ofroj më siguri, patjetër që do të tërhiqem dhe nuk besoj se do ta vuaj këtë, pasi do të rri më shumë me familjarët e mi dhe do t'u përkushtohem pasioneve të vogla që i kam lënë pas dore gjatë karrierës time", u shpreh portieri italian.

Vashat e Kosovës luftuan deri në fund, por nuk mjaftoi

PRISHTINË, 25 KORRIK - Kosova A (F) ka pësuar humbje nga Irlanda 86:72 (18:26, 17:15, 19:14, 32:17) në kuadër të Kampionatit Evropian për Shtete të Vogla. Kjo është hera e parë që Kosova A luan në gara ndërkombëtare. Kosova e nisi ndeshjen më mirë, duke qenë në epërsi konstante në periudhën e parë, me epërsi 9:17 e më pas 14:24, derisa këtë pjesë e fiton 18:26. Kosova vazhdoi me lojë të mirë, duke ngritur epërsinë sërish në dhjetë pikë, 19:29, më pas krijoi epërsinë më të lartë në ndeshje 26:37, por Irlanda me shtatë pikë radhazi ngushtoi shifrat në 34:37, kurse pjesa e parë përfundoi 35:41. Lojë shumë interesante dhe me kthesa u



zhvillua në çerekun e tretë, ku vashat e Kosovës sërish shkëputen në 38:45, më pas edhe në 46:53, por në fund të kësaj pjesë Irlanda me dy treshe

radhazi ngushton shifrat në 54:55, sa ishte rezultati në semafor pas 30 minutash. Lojë e barabartë u zhvillua deri në tre minutat e fundit, pranë rezultatit 71:74, ku vajzat nga Irlanda hyn në një seri prej 15:0 falë edhe efikasitetit të lartë për tri pikë dhe në fund fituan 86:72. Pavarësisht prej humbjes, vashat e Kosovës dhanë maksimumin dhe luftuan deri në fund. Te Kosova u dalluan Saranda Daci me 18 pikë e 10 kërcime, Alexis Tolefree me 16 pikë e gjashtë kërcime, Era Shatri me 11 pikë, katër kërcime e tri asistime dhe Arbnore Përquku me nëntë pikë e nëntë asistime. Kosova të dielën luan për vendin e tretë me humbësin e ndeshjes Luksemburgu - Malta.

SHKURT

Rrahmani: Spallettin nuk mund ta krahasoj me Gattuson

Amir Rrahmani luan sezonin e tij të dytë te Napoli teksa këtë sezon ai ka ndërruar trajner, me Luciano Spalletti që pasoi largimin e Gennaro Gattusos. Së fundmi kapiteni i Kosovës ka folur në lidhje me fazën përgatitore dhe ka treguar rreth ditëve të para nën drejtimin e trajnerit të ri, për të cilin Rrahmani ka fjalë të mira. "Duhet të luajmë sa më shumë miqësore, ka shumë lojtarë që ende nuk janë kthyer dhe po i presim ata. Gjithsesi të gjithë që jemi këtu po bëjmë më të mirën. Ndryshimet mes Spalletti dhe Gattuso? Është ende herët për të folur në lidhje me këtë. Spalletti është njeri pozitiv. Është trajner që e di se çfarë dëshiron, çfarë stili të lojës të adoptojë apo ç'të kërkojë nga lojtarët. Ai i njeht cilësitë tona, e di se çfarë mund të bëjmë dhe injekton idetë e parimet e tij te ne", ka thënë Rrahmani.

Icardi te Roma, Dzeko shkon në Juventus

Sulmuesi i PSG-së, Mauro Icardi dhe gruaja e tij Wanda Nara janë në bisedime me Romën, sipas gazetës "La Repubblica" dhe në këtë situatë Edin Dzeko mund të kalojë te Juventus. Jose Mourinho ka qenë prej kohësh admirues i Icardit dhe sulmuesi nuk është i kënaqur me faktin se nuk është titullar në PSG dhe trajneri Pochettino nuk e konsideron si një nga më të rëndësishmit e ekipit. Prej kohësh flitet se ish-sulmuesi i Interit dëshironte të kthehej në Serinë A dhe ishte i lidhur me Juventusin, por gjërat kanë ndryshuar dhe Wanda ka nisur të flasë me Romën, aty ku Icardi do ta kishte të sigurt vendin e titullarit. Zgjidhja mund të vijë me një marrëveshje huazimi, veçanërisht pasi Inter ka parashikuar në kontratën e shitjes se PSG do të paguante një gjobë të rëndë financiare nëse e shet atë sërish në një klub tjetër italian. Nëse Icardi do të transferohej te Roma, kjo do ta hapte derën që Dzeko të bashkohej me Juven, një lëvizje që ishte shumë pranë verën e shkuar. PSG është gati të pranojë një huazim dyvjeçar të Icardit, me detyrimin për ta blerë për rreth 30-35 milionë euro.

Milani kërkon Brandtin

AC Milan po kërkon një zëvendësues për mesfushorin Hakan Çalhanoglu i cili u transferua në Inter. Drejtuesit kuqezi kanë disa emra në mendje si Vlasic, Ilicic, Zijesh, Coutinho, James Rodriguez dhe, së fundmi, para disa ditësh doli në skenë edhe emri i Enis Bardhit. Sipas mediave italiane, një emër i ri ka dalë në pah për mesfushorin e Milanit dhe ai është futbollisti i Borussia Dortmundit, Julian Brandt. 25-vjeçari luan edhe në rolin e sulmuesit dhe do të ishte një ide mjaft e mirë për teknikun Pioli. Marrëveshja mund të arrihet me një huazim prej 5 milionë eurosh me blerje përfundimtare të kartonit 22 milionë euro. Për Dortmundin nuk do të ishte problem çmimi pas një formule të tillë marrëveshje arriti dhe me Lazio, por bardhekaltrit u tërhoqën më pas. Priten të reja në vazhdim sa i takon këtij operacioni.

Nedvedi sqaron të ardhmen e Ronaldos, Dybalas dhe Chiellinit

Zëvendës-presidenti i Juventusit, Pavel Nedved, hedh poshtë çdo mundësi të largimit të Cristiano Ronaldos nga bardhezinjtë. "Ronaldo? Po, do të kthehet. Është lajmëruar për të hënë, do të qëndrojë me ne". Një përgjigje e shkurtër dhe e prerë, që le pak vend

për dyshime. Nga CR7 te Paulo Dybala, që ende nuk ka rinovuar kontratën. "Marrëdhëniet nuk ishin të ftohta, ne jemi në kohën", ka shtuar Nedved pas miqësore së fituar 3-1 kundër Cesenës. "Cherubini është në kontakt me agjentin e tij. Ai do të

mbërrijë në ditët e ardhshme. Do të ketë një takim. Gjithçka po shkon siç duhet".

Për Chiellinin, kontrata e të cilit skadoi më 30 qershor, Nedved u shpreh: "Ai është me pushime. Kemi folur me të. Le t'i japim kohë të

rimëkëmbet, pastaj do të flasim për të ardhmen me qetësi. Bashkëjetesa midis Ronaldos dhe Dybalas? Është kënaqësi të kesh dy lojtarë të këtij niveli, Max ka shumë përvojë. Tani ai nuk i ka në dispozicion dhe po përmirëson lojtarët e rinj".

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Avdyl Avdyli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV si dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Hanemshah Halili nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

